

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 16597 Prot

Tiranë 07 .022024

Drejtuar: Operatorëve ekonomik të interesuar

Lënda: “KËRKESË PËR MARRJEN ME QIRA TË AMBIENTEVE PËR
NEVOJA TË INSPEKTORATIT TË MBROJTJES SË TERRITORIT, BASHKIA
TIRANË

Në zbatim të nenit 7 të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin“ me ndryshimet përkatëse, **Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë** kërkon nga ana juaj ofertë qeraje, me vendndodhje Brenda Qytetit të Tiranës.

Lutemi që oferta juaj të jepet në monedhën LEK /muaj, për sipërfaqe 1000 - 1100 m2.

I. Kriteret, specifikimet e ambientit dhe dokumentacioni që kërkohet nga ofertuesi qiradhënës.

1. INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT, BASHKIA TIRANË, kërkon të marrë me qira ambjent të përshtashëm lloji “ZYRA” me këto kriteret dhe specifikime si më poshtë vijon:

1. Ambient për zyra me sipërfaqe totale deri në 1100 m2, ku duhet të përfshijë të paktën: 23 (njëzetë e tre) ambiente për Zyra, 8 (tetë) Tualete (të kompletuar me pajisjet hidrosanitare dhe pajisjet për ujë të ngrohtë) dhe nje ambjent Magazinë.
2. Ambientet duhet të kenë të instaluar sistem vëzhgimi me kamera në hyrje të tyre.
3. Ambientet duhet të kenë furnizim me ujë dhe energji elektrike 24/7 dhe të jenë të pajisur me matës të dedikuar të ujit dhe energjisë elektrike.
4. Ambientet duhet të kenë sistem kondicionimi, të instaluar dhe plotësisht funksional.
5. Ambientet duhet të kenë rrjet interneti të instaluar (infrastrukturën e rrjetit), si dhe rrjetin e prizave të energjisë elektrike, për çdo post pune.
6. Ambientet duhet të jenë të përfunduara me dyer, dritare, të lyera dhe të gatshme/të lira për t’u shfrytëzuar nga qiramarrësi.
7. Ambientet duhet të jenë brenda Unazës së madhe të qytetit të Tiranë.
8. Ambientet duhet të jenë bosh dhe të lira.
9. Dorëzimi i objektit do të bëhet brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e nënshkrimit të kontratës.

10. Afati i kontratës së qiradhënies do të jetë 4 muaj nga data e marrjes në dorëzim të ambienteve, me të drejtë rinovimi.
11. Afati do të përcaktohet gjithmonë nga qiramarrësi, i cili njofton me shkrim 30 ditë para mbarimit të kontratës qiradhënësin.
12. Detyrimet që lindin nga përdorimi i energjisë elektrike, ujit dhe internetit gjatë periudhës së vlefshmërisë së Kontratës së qirasë do të përmbushen nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë.

2. Oferta e qiradhënësit duhet të jetë e shoqëruar me:

- 1- Kërkesë e e subjektit/individit për pjesëmarrje në konkurrim.
- 2- Deklarata e hollësishme për vënien në funksionim të objektit;
- 3- Të jenë titullarë të ligjshëm të pronës të vërtetuar me certifikate pronësie, lëshuar nga ASHK-ja, shoqëruar me kartelën e pasurisë, hartën treguese të pronës dhe Gent-planin.
- 4- Kartele e rifreskuar e pronës, lëshuar nga ASHK-ja.
- 5- Vërtetim nga FSHU-ja që nuk ka detyrime të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit të energjisë elektrike.
- 6- Vërtetim nga UKT-ja që nuk ka detyrime të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit nga ujësjellës-kanalizimet.
- 7- Vetëdeklarim që subjekti apo përfaqësuesi ligjor i tij nuk është në ndjekje penale apo proces gjyqësor.
- 8- Nëse është tregtar/shoqëri tregtare duhet të paraqesë edhe:
 - a) NIPT/NUIS, certifikata e regjistrimit dhe Ekstrat Historik i regjistrimit të subjektit që vërteton se ka status aktiv.
 - b) Vërtetim nga tatim-taksat që nuk ka detyrime të pashlyera.
 - c) Vërtetim që nuk ka sigurime shoqërore të pashlyera nga e-Sigurime.
 - d) Në ofertën e tij subjekti i interesuar, duhet të japë të dhëna të sakta të personit të kontaktit.
- 9- Vetëdeklarim që ofertuesi nuk është në konflikt interesi me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit
- 10- Vetëdeklarim për plotësimin e të gjitha kritereve ligjore dhe kërkesave specifike të ambienteve që kërkohen nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit
- 11- Kopje ID e titullarit të pronës/ambienteve.
- 12- Vërtetim të numrit të llogarisë bankare në një nga bankat e nivelit të dytë në RSH.
- 13- Ofertë me shkrim e çmimit të qirasë së ambienteve në muaj (veç kërkesave të tjera, oferta të jetë e nënshkruar nga administratori ose pronari i ambientit dhe të përmbajë të dhënat, sipas tabelës më poshtë).

Nr	Emri (ID dhe/ose NIPT)	Përshkrimi	Njësia	Sipërfaqja totale	Cmimi/m ²	Cmimi total/ muaj
1		Ambjente me qera	m ²			
Çmimi pa TVSH						
TVSH (%)						
Çmimi total me TVSH:						

Ofertuesi duhet të përcaktojë çmimin (oferta ekonomike), vlerën mujore të qirasë për një muaj, duke përfshirë të gjitha detyrimet tatimore sipas legjislacionit në fuqi.

Pagesa e qirasë do bëhet çdo muaj në llogarinë në lekë të qiradhënësit, brenda datës që palët do të bien dakord në kontratën me shkrim, kundrejt lëshimit të faturës tatimore elektronike për subjektet tregtare. Në rast se qiradhënësi është individ dhe nuk mund të lëshojë faturë tatimore, pagesa e detyrimeve do të kryhet nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në përputhje me legjislacionin në fuqi për taksat dhe tatimet dhe shuma e detyrimeve do ti zbritet qiradhënësit nga vlera e qirasë.

Të interesuarit (ofertuesit qiradhënës) duhet të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin brenda datës 19.02.2024, në Protokollin e Autoritetit “Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë”, Adresa: Rr: “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë.

Oferta fituese do të jetë:

Oferta e cila, në bazë të kriterëve dhe kërkesave të përcaktuara në “Njoftimin për Publikim”ose “Website-in Zyrtar” plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktor për objektin e kontratës së qiramarrjes me çmimin më të ulët,

Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në “Njoftimin për Publikim” ose “Website-in Zyrtar” nga Autoriteti Kontraktor për objektin e kontratës së qiramarrjes, të shpallur pranë stëndave të Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë.

Faleminderit për bashkëpunimin,

Me Respekt,

KRYEINSPEKTOR

Herion Krapaj

